



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 99

Tiranë – E enjte, 14 maj 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 288, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8777
Dekret i Presidentit nr. 289, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8777
Dekret i Presidentit nr. 290, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8777
Dekret i Presidentit nr. 291, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8777
Dekret i Presidentit nr. 292, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8778
Dekret i Presidentit nr. 293, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8778
Dekret i Presidentit nr. 294, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8778
Dekret i Presidentit nr. 295, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8779
Dekret i Presidentit nr. 296, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8779
Dekret i Presidentit nr. 297, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8779
Dekret i Presidentit nr. 298, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 8780

Dekret i Presidentit nr. 299, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8780
Dekret i Presidentit nr. 300, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8780
Dekret i Presidentit nr. 302, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8780
Dekret i Presidentit nr. 303, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8781
Dekret i Presidentit nr. 304, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8781
Dekret i Presidentit nr. 305, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8781
Dekret i Presidentit nr. 306, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8782
Dekret i Presidentit nr. 307, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8782
Dekret i Presidentit nr. 308, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8782
Dekret i Presidentit nr. 309, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8783
Dekret i Presidentit nr. 310, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8783
Dekret i Presidentit nr. 311, datë 11.5.2026	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	8783
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 10, datë 14.5.2026	Për procedurat e marrëveshjes së pages fiskale.....	8783
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 11, datë 14.5.2026	Për zbatimin e ligjit nr. 86/2025, “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë”	8798

**DEKRET****Nr. 288, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Fisnik Nafi Dafota

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 289, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Arianit Beqir Haxhosaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 290, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Tatiana Yuri Kabali

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 291, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Teuta Zykë Weiß
2. Rezarta Shpëtim Allmuça

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 292, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Arba Blerim Bilibani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 293, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Atli Ramadan Koleci

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 294, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Michele Silvestro De Vita



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 295, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Sarah Stephanie U Bold Nelson Patrick Walker

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 296, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Maksym Volodymyr Zavershynskyi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 297, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetases:

1. Laura Renato Mattei

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 298, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Syed Abdullah Syed Shafiqur Rahman Galib

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 299, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Simon Rajaseelan Arulanandam Yesudian Samuel Gnanam

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 300, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Ahmet Selami Kaplan

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 302, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Haxhire Luan Eminaj
2. Ermal Hate Dauti

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 303, datë 11.5.2026

PËR DHËNIE TË SHQIPTARISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Raimonda Esat Xhelilaj
2. Amis Ilir Allushi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 304, datë 11.5.2026

PËR DHËNIE TË SHQIPTARISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Manuela Nexhip Balli
2. Kastriot Aqif Kenga

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 305, datë 11.5.2026

PËR DHËNIE TË SHQIPTARISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Blerina Pilo Jaku
2. Hedi Osman Meti



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 306, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Agron Raif Palla
2. Ermir Sali Saraçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 307, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Arbër Vangjel Gjoka
2. Kleant Xhemal Demuçaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 308, datë 11.5.2026

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Naim Mehmet Mehmeti
2. Albana Azem Dervishi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 309, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Lindita Qemal Mustafa

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 310, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Al Hasan Bachar Al Naasani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 311, datë 11.5.2026****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës, neneve 9, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Zehra Senol Senol

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

UDHËZIM**Nr. 10, datë 14.5.2026****PËR PROCEDURAT E MARRËVESHJES
SË PAQES FISKALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 84/2025, “Për marrëveshjen e paqes fiskale”, ministri i Financave



UDHËZON:

1. Objekti

Ky udhëzim përcakton procedurat për hartimin dhe përmbajtjen e propozimit të marrëveshjes së paqes fiskale, mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin dhe konfirmimin elektronik, regjistrimin dhe ruajtjen e marrëveshjes në regjistrin elektronik tatimor, si dhe trajtimin e rasteve të refuzimit, mospranimit, përfundimit të vlefshmërisë ose pavlefshmërisë së marrëveshjes.

2. Aplikimi nga tatimpaguesi

2.1 Tatimpaguesi që ka dorëzuar deklaratën vjetore të Tatimit mbi të Ardhurat e Korporatës (TAK) ose Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi (TAPB), i cili gjatë vitit tatimor paraardhës ka realizuar të ardhura bruto mbi 14 milionë lekë, nuk ka përfituar nga ndonjë normë e reduktuar apo përjashtim tjetër tatimor dhe plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 7, të ligjit “Për marrëveshjen e paqes fiskale” (këtu e në vijim “ligji”), aplikon elektronikisht për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale.

2.2 Aplikimi për marrëveshjen e paqes fiskale duhet të dorëzohet brenda afatit për dorëzimin e deklaratës vjetore të të ardhurave të vitit paraardhës, pra brenda datës 31 mars të vitit për të cilin aplikohet marrëveshja. Për vitin e parë tatimor të zbatimit, pra viti tatimor 2026, afati i aplikimit për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale dhe nënshkrimi elektronik i saj nga tatimpaguesi përcaktohet me udhëzim/sqaruese të drejtorit të përgjithshëm të tatimeve, i cila do të njoftohet nëpërmjet kanaleve të komunikimit dhe do të publikohet në faqen zyrtare të administratës tatimore.

2.3 Në modulën “Çështjet e mia”, në sistemin *e-Filing* krijohet shërbimi “Aplikim për marrëveshjen e paqes fiskale”. Formulari i aplikimit “Për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale” pasqyrohet në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2.4 Pas aplikimit nga tatimpaguesi, në sistemin C@TS krijohet automatikisht një çështje tek rubrika “Çështjet e mia” në sistemin *e-Filing*.

3. Administrimi fillestar i çështjes

3.1 Në rastet kur tatimpaguesi ka detyrime tatimore të papaguara ose të padeklaruara, çështja refuzohet automatikisht, duke dhënë arsytimin përkatës.

3.2 Në rastet kur tatimpaguesi nuk ka detyrime tatimore të papaguara ose të padeklaruara, çështja i

adresohet drejtorit të kontrollit pranë drejtorisë rajonale tatimore (DRT) të juridiksionit ku është i regjistruar tatimpaguesi, për verifikimin për plotësimin e kriterëve të tjera ligjore, sipas nenit 7 të ligjit.

4. Verifikimi i kriterëve ligjore

4.1 Drejtoria e Kontrollit pranë DRT-së përkatëse verifikon nëse tatimpaguesi ka dorëzuar:

a) Vërtetimin e lëshuar nga prokuroria e juridiksionit të përgjithshëm ku është i regjistruar tatimpaguesi, që vërteton se subjekti nuk është në proces procedimi penal për vepra penale në fushën tatimore.

Ky vërtetim paraqitet për personin juridik, administratorët dhe pronarët përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues;

b) Dëshmitë e penalitetit që vërteton se nuk janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e tatimeve, pastrimit të produkteve të veprës penale ose fshehjes së të ardhurave, për personin juridik, administratorët dhe pronarët përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për regjistrin e pronarëve përfitues;

c) Vërtetimin nga Drejtoria e Apelit Tatimor për ankimet te Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Komisioni i Shqyrtimit të Apeliteve Tatimore, që nuk është në proces ankimi administrativ;

ç) Vetëdeklarimin e tatimpaguesit që nuk realizon projekte koncesionare;

d) Vetëdeklarimin se në dijeninë e aplikuesit, ai nuk është në dijeni të ekzistencës së procedimeve, sipas gërmës “a” të këtij neni.

4.2 Në rast të plotësimit kushteve sipas pikës 4.1, Drejtoria e Kontrollit pranë DRT-së, verifikon nëse tatimpaguesi është ose jo subjekt hetimi nga administrata tatimore dhe nëse realizon ose jo projekte koncesionare. Për verifikimet sipas kësaj pike, merren në konsideratë:

a) listat e përcjella paraprakisht nga Drejtoria e Hetimit Tatimor për subjektet nën hetim për të cilat nuk është bërë ende referim pranë organit të prokurorisë; dhe

b) lista e projekteve koncesionare. Lista e projekteve koncesionare kërkohet zyrtarisht nga DPT-ja pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe i shpërndahet DRT-ve.



4.3 Nëse të gjitha kriteret e mësipërme plotësohen, inspektori procedon me hartimin e draftmarrëveshjes.

5. Hartimi i marrëveshjes

5.1 Sistemi gjeneron dokumentin “Marrëveshja e paqes fiskale”, duke përfshirë:

a) fitimin e tatueshëm të vlerësuar, i cili llogaritet duke shtuar me 18% fitimin e tatueshëm të vitit të mëparshëm tatimor për të cilin hartohet marrëveshja;

b) normën tatimore që aplikohet për fitimin e tatueshëm të vlerësuar dhe çdo fitim shtesë;

c) përlogaritjen mbi bazën vjetore të llogaritjes së kësteve paraprake;

ç) shpërndarjen e kësteve për periudhën e mbetur të vitit tatimor;

d) në rast se tatimpaguesi në formularin e aplikimit të marrëveshjes, ka shprehur se do të kryejë edhe rideklarimin e pasqyrave financiare, Marrëveshja do të ketë të përfshirë edhe të drejtën për rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë, sipas normës së tatimit dhe procedurës së përcaktuar në këtë ligj. Për zbatimin e kësaj pike, tatimpaguesi plotëson dhe dorëzon formularin e aplikimit, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Nënshkrimi elektronik dhe lidhja e marrëveshjes

6.1 Draftmarrëveshja nënshkruhet dhe vulolet elektronikisht nga titullari i drejtorisë rajonale tatimore të juridiksionit dhe dokumenti i dërgohet tatimpaguesit për nënshkrim elektronik në “*Dokumentat e mia*”, në sistemin *e-Filing*, brenda datës 10 prill të vitit për të cilin lidhet marrëveshja.

6.2 Tatimpaguesi nënshkruan elektronikisht dokumentin dhe e ringarkon në të njëjtën çështje brenda datës 15 prill të vitit për të cilin lidhet marrëveshja.

6.3 Gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes së paqes fiskale për përgjegjësitë e Tatimit mbi të Ardhurat të Korporatës dhe Tatimin mbi të Ardhurat Personale nga Biznesi, nuk kryhen kontrole tatimore në kuptim të pikës 80.3 (a), të udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përveç rasteve kur për tatimpaguesin është regjistruar një çështje hetimore në proces për konsumin e veprës penale të krijimit të skemave mashtruese me tatimin mbi vlerën e shtuar apo fshehje e të ardhurave, sipas

parashikimeve në Kodin Penal. Megjithatë, gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes, tatimpaguesit do të vijojnë t'i nënshtrohen vlerësimit periodik nga zyra për qëllime monitorimi, në zbatim të ligjit në fuqi për procedurat tatimore.

6.4 Pas nënshkrimit elektronik të marrëveshjes nga të dyja palët, marrëveshja konsiderohet e lidhur në datën e nënshkrimit elektronik nga tatimpaguesi dhe prodhon efekte ligjore për vitin tatimor përkatës. Aplikuesi i cili në formularin e aplikimit për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale, sipas shtojcës nr. 1 të këtij udhëzimi, ka deklaruar që do të kryejë rideklarimin e pasqyrave financiare për një ose disa nga vitet tatimore dhe kryen rideklarimin e këtyre pasqyrave financiare, duhet të dorëzojë pranë drejtorisë rajonale tatimore të juridiksionit formularin e aplikimit për rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore, sipas shtojcës nr. 2 të këtij udhëzimi, shoqëruar me dokumentacionin bashkëlidhur këtij formulari, brenda datës 30 qershor të vitit kur lidhet Marrëveshja. Aplikimi sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe rideklarimi i pasqyrave financiare sipas kësaj pike bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të përsëritet apo të korrigjohet. E drejta e rideklarimit të elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore bëhet vetëm nga subjektet që kanë lidhur marrëveshjen e paqes fiskale.

6.5 Për rideklarimet e elementeve të veçanta të pasqyrave financiare të kryera në përputhje me nenin 6, të ligjit, nuk do të aplikohen dënimet administrative (gjoha, interesa apo kamatëvonesa) të cilat gjenerohen nga sistemi elektronik i tatimeve, sipas legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore. Drejtoria rajonale tatimore merr masa për sistemimin e këtyre penaliteteve. Në pikën 2, të shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi, pasqyrohen shembuj konkretë, për rideklarimin e transaksioneve të veçanta të pasqyrave financiare vjetore.

6.6 Për elementet e veçanta të pasqyrave financiare, të rideklaruara në përputhje me nenin 6, të ligjit, nuk ushtrohet kontroll tatimor, sipas nenit 80, të ligjit “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar. Ky përjashtim vlen vetëm për pjesën e elementeve të rideklaruara, në zbatim të nenit 6 të ligjit. Ndërsa, për deklaratat fillestare sipas përgjegjësisë tatimore,



të cilat në zbatim të nenit 6 të ligjit rideklarohen, administrata tatimore ruan të drejtën për të ushtruar kontroll tatimor të deklaratave fillestare në bazë të analizës së riskut, sipas nenit 80, të ligjit “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar.

7. Gjenerimi i shtesës së kësteve paraprake dhe raportimi

7.1 Pas lidhjes së marrëveshjes, sistemi gjeneron shtesën e kësteve paraprake për TAK ose TAPB.

7.2 Gjenerohen këstet paraprake nga Plani i Parapagimeve, si dhe shtesat e bazuara në marrëveshjen e paqes fiskale.

7.3 Për të përlogaritur efektin e marrëveshjes, krijohet një raport në bazë të kësteve shtesë të gjeneruara, i cili evidenton diferencën midis totalit të planeve të parapagimit të kësteve dhe planeve të mbledhjes së kësteve të gjeneruara në bazë të marrëveshjes.

7.4 Përlogaritjet përfundimtare të tatimit kryhen në Deklaratën Vjetore Tatimore. Në pikën 1, të shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi, pasqyrohen shembuj konkretë për llogaritjen e fitimit të tatueshëm të vlerësuar, këstet paraprake dhe TAK ose TAPB të llogaritur në deklaratën vjetore.

8. Përfundimi i marrëveshjes dhe ndryshimet e kësteve

8.1 Për qëllime të zbatimit të nenit 10, të ligjit, përfundimi i vlefshmërisë së marrëveshjes së paqes fiskale konsiderohet se ndodh në rastet e mëposhtme:

a) tatimpaguesi ndryshon llojin e veprimtarisë së deklaruar në marrëveshje. Ndryshim i llojit të veprimtarisë ekonomike konsiderohet çdo ndryshim i veprimtarisë së ushtruar nga tatimpaguesi që nuk përputhet me veprimtarinë e përcaktuar në marrëveshje.

b) tatimpaguesi nuk realizon rritjen e fitimit të tatueshëm në mbi 18% krahasuar me vitin paraardhës. Mosrealizimi i këtij kriteri vlerësohet në përfundim të vitit tatimor për të cilin është lidhur marrëveshja, bazuar në deklaratën vjetore të TAK apo TAPB;

c) kur tatimpaguesi ka kërkuar pezullimin ose ndërprerjen përfundimtare të aktivitetit ekonomik. Kalimi në statusin pasiv, kërkesa për çregjistrim apo çregjistrimi përfundimtar i veprimtarisë ekonomike sipas të dhënave të regjistruara në QKB;

ç) ka kryer shkelje të përsëritura të detyrimeve tatimore që cenojnë ndershmërinë fiskale. Nëse

tatimpaguesi përsërit të paktën dy herë shkelje të lidhura me detyrimet tatimore, si për shembull TVSH-në, kontributet, tatimin në burim dhe të tjera, sipas legjislacionit tatimor në fuqi, atëherë marrëveshja humbet vlefshmërinë në momentin që shkelja ndodh për herë të dytë;

d) mospagimi i detyrimeve sipas marrëveshjes. Mospagim konsiderohet:

i. mosshlyerja, brenda afateve të përcaktuara të kësteve të parapagimeve, TAK apo TAPB. Në rast se edhe për një muaj, tatimpaguesi nuk paguan në afat këstet, marrëveshja konsiderohet e prishur;

ii. në rastet kur tatimpaguesi ka nënshkruar në marrëveshje për të bërë edhe rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare, të paguajë edhe detyrimet sipas nenit 6 të ligjit;

dh) nuk plotësohen kushtet e nenit 6 të ligjit. Në rast se tatimpaguesi, në aplikimin e tij për Marrëveshjen ka zgjedhur rideklarimin edhe të elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare deri në tri vitet e fundit, mosplotësimi i kushteve sipas ligjit për rideklarimin e elementeve të veçanta të pasqyrave financiare vjetore, cenon marrëveshjen dhe shkakton përfundimin e saj;

e) rritet fitimi i tatueshëm mbi 50% në vitin tatimor për të cilin është lidhur marrëveshja krahasuar me vitin tatimor paraardhës. Rritja e fitimit të tatueshëm mbi 50% vlerësohet në përfundim të vitit tatimor përkatës, duke krahasuar fitimin e deklaruar me atë të vitit tatimor paraardhës. Në këtë rast, aplikohet norma e tatimit prej 15% mbi të gjithë fitimin e tatueshëm.

Për të gjitha rastet më sipër kur prishet marrëveshja, administrata tatimore përlogarit detyrimin për tatimin mbi fitimin ose tatimin mbi të ardhurat nga biznesi, sipas normave të parashikuara në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, mbi të gjithë shumën e fitimit të tatueshëm, bazuar në deklaratën vjetore të TAK apo TAPB.

8.2 Nëse gjatë periudhës nga momenti i lidhjes së marrëveshjes deri më 31 dhjetor të vitit tatimor për të cilin është lidhur marrëveshja, plotësohet ndonjë nga kushtet për përfundimin e saj sipas nenit 10 të ligjit “Për marrëveshjen e paqes fiskale”, Drejtoria e Kontrollit pranë DRT-së përkatëse kryen manualisht ndryshimin e Planit të Kësteve dhe tatimpaguesi humbet përfitimet e parashikuara në ligji.



8.3 Tatimpaguesi humbet përfitimet e parashikuara në ligj, kur:

a) tatimpaguesi ka aplikuar për përfundimin e marrëveshjes, sipas shkronjave “b”, “c” dhe “d”, të nenit 10, të ligjit për marrëveshjen e pages fiskale;

b) strukturat përkatëse konstatojnë plotësimin e kushteve sipas nenit 10, të ligjit për marrëveshjen e pages fiskale.

8.4 Në të dyja rastet e mësipërme, pas përfundimit të marrëveshjes, ndryshimi dhe përlllogaritja e kësteve për periudhën e mbetur kryhet manualisht, duke marrë parasysh edhe pagesat e kësteve të kryera sipas marrëveshjes.

8.5 Në rastet kur përfundon marrëveshja si shkak i plotësimit të paktën të njërit nga kushtet e listuara në pikën 1, të nenit 10 të ligjit, dhe ndërkohë tatimpaguesi ka rivlerësuar pasqyrat financiare sipas nenit 6 të ligjit, administrata tatimore kryen kontrollin dhe rivlerësimin e detyrimit tatimor, në përputhje me normat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.

9. Regjistrimi dhe ruajtja në regjistrin elektronik

9.1 Marrëveshja regjistrohet në Regjistrin Elektronik Tatimor, me numër unik, datën e lidhjes, të dhënat e tatimpaguesit, llogaritjet dhe historikun e veprimeve, përfshirë edhe dokumentacionin e aplikimit dhe pranimin të tij.

9.2 Dokumentet ruhen në arkivin elektronik për 15 vjet nga momenti i mbylljes së marrëveshjes.

10. Trajtimi i refuzimit, mospranimit ose pavlefshmërisë

10.1 Refuzimi i marrëveshjes së pages fiskale ndodh në rastet kur, gjatë administrimit fillestar të çështjes ose gjatë verifikimit të kriterëve ligjore, sipas nenit 7 të ligjit dhe pikave 2, 3 dhe 4 të këtij udhëzimi, konstatohet se tatimpaguesi nuk plotëson një ose më shumë nga kushtet ligjore për lidhjen e marrëveshjes.

10.2 Në rast refuzimi, administrata tatimore, përmes sistemit *e-Filing*, i kthen përgjigje tatimpaguesit në çështjen e hapur për aplikimin e marrëveshjes, duke e refuzuar këtë marrëveshje dhe duke ia komunikuar tatimpaguesit arsyen e refuzimit. Refuzimi sjell mbylljen e çështjes dhe marrëveshja nuk lidhet, duke mos prodhuar asnjë efekt juridik për vitin tatimor përkatës.

10.3 Tatimpaguesi, ndaj të cilit është marrë vendim refuzimi, nuk përfiton nga lehtësitë dhe përfitimet e parashikuara në ligjin për marrëveshjen

e pages fiskale për vitin tatimor përkatës, por ka të drejtë të aplikojë sërish për vitet pasuese tatimore, nëse plotëson kushtet ligjore.

10.4 Mospranimi i marrëveshjes konsiderohet kur tatimpaguesi, pas marrjes së draftmarrëveshjes të nënshkruar elektronikisht nga administrata tatimore, nuk e nënshkruan elektronikisht marrëveshjen brenda afatit të përcaktuar në pikën 6.2 të këtij udhëzimi. Në këtë rast, marrëveshja konsiderohet e panënshkruar dhe nuk prodhon efekte juridike.

10.5 Në rast mospranimi të marrëveshjes nga tatimpaguesi, çështja mbyllet automatikisht në sistemin *e-Filing* dhe detyrimet tatimore të tatimpaguesit për vitin tatimor përkatës administrohen dhe përlllogariten sipas rregullave të përgjithshme të legjislacionit tatimor në fuqi.

10.6 Pavlefshmëria e marrëveshjes konsiderohet kur, pas lidhjes së saj, rezulton se:

a) marrëveshja është lidhur mbi bazën e të dhënave të pasakta, deklarimeve të rreme ose dokumentacionit të pavërtetë të paraqitur nga tatimpaguesi, në kundërshtim me dispozitat e ligjit për marrëveshjen e pages fiskale ose të këtij udhëzimi;

b) ndaj tatimpaguesit, administratorit dhe/ose pronarëve përfitues, ka filluar hetim nga Prokuroria e Juridiksionit të Përgjithshëm ose nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për veprat penale të parashikuara në nenin 4, pika 4.1, shkronja “a” e këtij udhëzimi.

10.7 Në rast pavlefshmërie të marrëveshjes, administrata tatimore kryen rivlerësimin e plotë të detyrimeve tatimore për periudhën përkatëse, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi, duke përfshirë tatimin e plotë, interesat dhe penalitetet përkatëse, pa u kufizuar nga kushtet dhe përfitimet e parashikuara në marrëveshjen e pages fiskale.

10.8 Vendimi për refuzimin, mospranimin ose pavlefshmërinë e marrëveshjes regjistrohet pranë Administratës Tatimore dhe i komunikohet tatimpaguesit në mënyrë elektronike, përmes sistemit *e-Filing*.

11. Dispozitë kalimtare

11.1 Për një periudhë kalimtare, deri në mundësimin e aplikimit elektronik për lidhjen e “Marrëveshjes së pages fiskale”, formulari/ët i/e aplikimit, si dhe dokumentacioni shoqërues, do të paraqitet në formë shkresore, pranë drejtorisë rajonale tatimore të juridiksionit.



11.2 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve merr masat për njoftimin e tatimpaguesve në momentin e mundësimin të aplikimit në rrugë elektronike.

12. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

SHTOJCA NR. 1

FORMULAR APLIKIMI

PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES SË PAQES FISKALE

(Sipas neni 5 të Ligjit nr. 84/2025)

I. TË DHËNAT E TATIMPAGUESIT

- Numër Identifikimi i Tatimpaguesit (NIPT): _____
- Emri i Tatimpaguesit: _____
- Emri tregtar (nëse ka): _____
- Forma ligjore: ☐ Person Fizik ☐ Shoqëri tregtare/entitet
- Adresa: _____
- E-mail: _____
- Nr. Tel/Mob: _____
- Drejtoria Rajonale e Tatimeve: _____
- Kodi i aktivitetit (NVE): _____

II. VLERËSIMI I FITIMIT TË TATUESHËM

- Viti tatimor: _____
- Lloji i tatimit (zgjidhet vetëm një sipas formës ligjore):
 - ☐ Tatim mbi të ardhurat e korporatës
 - ☐ Tatim mbi të ardhurat personale nga biznesi

III. RIDEKLARIMI I ELEMENTEVE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Referuar pikës 1 te nenit 6 të Ligjit nr. 84/2025, deklaroj se:

- ☐ **do të kryej rideklarimin e pasqyrave financiare** për periudhat tatimore _____
- ☐ **nuk do të kryej rideklarimin e pasqyrave financiare** për periudhat tatimore të mëparshme

*Shënim: Nëse subjekti do të kryejë rideklarimin e pasqyrave financiare, duhet të përcaktojë edhe periudhën tatimore për të cilën do të kryhet ky rideklarim. Periudhat tatimore për të cilat kryhet rideklarimi, nuk mund të jenë më shumë se tre vitet e mëparshme tatimore, _____, _____, _____.

**IV. DEKLARATË SIPAS NENIT 7 TË LIGJIT NR. 84/2025**

Deklaroj me përgjegjësi ligjore se subjekti:

1. Nuk ka detyrime tatimore të papaguara ose të padeklaruara;
2. Nuk është në proces ankimi administrativ (vërtetim nga Drejtoria e Apelit Tatimor për ankimimet tek Drejtoria e Apelit Tatimor dhe Komisioni i Shqyrtimit të Apelimeve Tatimore);
3. Nuk është subjekt hetimi nga administrata tatimore;
4. Nuk është subjekt i procedimit penal tatimor (vërtetim nga Prokuroria e Juuridiksionit të Përgjithshëm ku është i regjistruar subjekti);
5. Nuk ka vendim penal të formës së prerë për vepra penale në shumën tatimore/pastrim parash (dëshmi penaliteti);
6. Nuk realizon projekte koncesionare.

V. DOKUMENTACIONI BASHKËNGJITUR

Vërtetimet përkatëse sipas nenit 7 të ligjit:

☐ Vërtetim që nuk është në proces ankimi administrativ - nga Drejtoria e Apelit Tatimor

☐ Vërtetim që nuk është subjekt hetimi apo procedimi penal tatimor (nga Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit)

☐ Vërtetim që nuk ka vendim penal të formës së prerë për mashtrim tatimor/pastrim parash (dëshmi penaliteti)

Deklaroj se, fitimi i tatueshëm i vitit ushtrimor _____ parashikohet të rritet sipas normave të parashikuara në Ligjin nr. 84/2025 dhe shpreh dakordësinë që Administrata Tatimore të korrigjojë dhe gjenerojë kështu përkatëse në kuadër të marrëveshjes së Paqes Fiskale, sipas referencave të nenit 5 të këtij Ligji.

Aplikuesi/Administratori i shoqërisë

Emër Mbiemër

(Nënshkrimi/Vula)



SHTOJCA NR. 2

FORMULAR APLIKIMI

**PËR RIDEKLARIMIN E ELEMENTEVE TË VEÇANTA TË AKTIVEVE, TË
DETYRIMEVE APO TË KAPITALEVE TË VETA TË TË PASQYRAVE FINANCIARE**
(Sipas neni 6 të Ligjit nr. 84/2025)

I. TË DHËNAT E TATIMPAGUESIT

- Numër Identifikimi i Tatimpaguesit (NIPT): _____
- Emri i Tatimpaguesit: _____
- Emri tregtar (nëse ka): _____
- Forma ligjore: ☐ Person Fizik ☐ Shoqëri tregtare/entitet
- Adresa: _____
- E-mail: _____
- Nr. Tel/Mob: _____
- Drejtoria Rajonale e Tatimeve: _____
- Kodi i aktivitetit (NVE): _____

II. RIDEKLARIMI I ELEMENTEVE TË PASQYRAVE FINANCIARE

Në aplikimin e kryer për marrëveshjen e paqes fiskale sipas ligjit 84/2025, referuar pikës 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 84/2025 **kam deklaruar që do të kryej rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare.**

Ky aplikim është miratuar me nr. _____ Prot., datë _____, dhe referuar nenit 6 të Ligjit nr. 84/2025, deklaroj se, kam konstatuar pasaktësi në pasqyrat financiare të periudhës/ave tatimore _____ dhe paraqes kërkesën për vijimin e procedurës së rideklarimit të tyre, duke pranuar pagesën e tatimit në masën 5%.

	Zëri që rideklohet	Gjendja e Llogarisë sipas pasqyrës së dorëzuar	Gjendja e Llogarisë sipas Rideklarimit	AKTIV Shtesa/Pakësimi	PASIV Shtesa / Pakësimi	Tatimi për t'u paguar
A	Aktive monetare					
A	Aktive të tjera financiare afatshkurtra/					



A	Fshirja e aktiveve afatgjata materiale/jo materiale					
A	Deklarim i aktiveve afatgjata materiale/jo materiale të pa përfshira ne PF					
P	Fshirja e Detyrimeve/Borxheve					
P	Rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij					
	Shuma					

III. DOKUMENTACIONI BASHKËNGJITUR

- Pasqyrat financiare të rideklaruara;
- Deklarata tatimore e ndryshuar për secilin vit tatimor ndryshohet si më poshtë:
 - Për deklaratat e vitit 2023 dhe 2024, vendoset shuma totale e ridekluar në rubrikën (18) “Fitimi i tatueshëm neto” dhe shuma e tatimit për t’u paguar duke plotësuar rubrikën (21) “Tatim fitimi me përqindje të tjera”;
 - Për deklaratën e vitit 2025 e në vijim, vendoset të dhënat në rubrikat (48/49) “Tatimi mbi të ardhurat e korporatës me shkallë tatimore të tjera”, konkretisht vendoset shuma totale e ridekluar në rubrikën (48) “Baza e tatueshme”, dhe shuma e tatimit për t’u paguar vendoset në rubrikën (49) “Tatimi”.
- Pagesa e tatimit të kryer për çdo vit tatimor për të cilin është ndryshuar deklarata tatimore, brenda datës 30 qershor të vitit kur është lidhur marrëveshja.

Aplikuesi/Administratori i shoqërisë

Emër Mbiemër

(Nënshkrimi/Vula)



SHTOJCA NR. 3

1. SHEMBUJ PËR LLOGARITJEN E FITIMIT TË TATUESHËM TË VLERËSUAR, KËSTET PARAPRAKE PER TAK OSE TAPB:
Shembulli nr.1:

Subjekti “xxx shpk.”, entitet, subjekt i TAK-es, gjatë vitit 2026 ka patur të ardhura bruto prej 30,000,000 lekë, ndërkohë fitimi i tatueshëm i realizuar për këtë periudhë ka qenë 2,800,000 lekë.

- Për vitin 2027 subjekti, i cili plotëson të gjitha kriteret sipas ligjit “Për marrëveshjen e paqes fiskale”, pasi ka dorëzuar deklaratën TAK 2026, aplikon brenda datës 31 mars 2027 për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale.
- Administrata tatimore, pas administrimit të kërkesës së tatimpaguesit, dhe verifikimit të kriterëve ligjore, mbi bazën e formulës së vlerësimit, harton dhe i propozon tatimpaguesit vlerën e paracaktuar të fitimit të tatueshëm, që do përdoret për llogaritjen e detyrimit tatimor gjatë periudhës së marrëveshjes, normën tatimore, si dhe përllogaritjen e kësteve paraprake dhe shpërndarjen e kësteve për periudhën e mbetur të vitit tatimor.

1. Sa do të jetë fitimi i tatueshëm i vlerësuar për të cilin do të nënshkruhet marrëveshja?	• Fitimi i tatueshëm i vlerësuar në marrëveshje = Fitimi i vitit paraardhës për të cilin lidhet marrëveshja + 18%* e Fitimit të vitit paraardhës. • $2,800,000 \text{ lekë} + 18\% \cdot 2,800,000 \text{ lekë} = 3,304,000 \text{ lekë}$ Pra marrëveshja me tatimpaguesin “xxx shpk.”, për vitin tatimor 2026, do të nënshkruhet për fitimin e tatueshëm prej 3,304,000 lekë.
2. Cila do të jetë norma që do të aplikohet për fitimin e tatueshëm të vlerësuar në marrëveshje?	• Për tatimpaguesit të cilët janë pjesë e fushës së zbatimit të këtij ligji, në bazë të nenit 41, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, norma tatimore është 15% e fitimit të tatueshëm. • Për sa më lart, në marrëveshje do të përcaktohet se norma tatimore për fitimin e tatueshëm të vlerësuar prej 3,304,000 lekë është 15%, dhe se për çdo fitim shtesë mbi vlerën 3,304,000 lekë për vitin tatimor 2027, do të paguhet 5%.
3. Sa do të jenë këstet e tatimit mbi të ardhurat e korporatës që do të paguajë tatimpaguesi dhe si do të bëhet shpërndarja e kësteve për periudhën e mbetur të vitit tatimor?	• Totali i vlerës së kësteve paraprake për t’u paguar do të jetë $3,304,000 \text{ lekë} \cdot 15\% = 495,600 \text{ lekë}$. • Shpërndarja e kësteve do të kryhet në Planin e Parapagimit, për periudhën Prill 2027 – Mars 2028, sipas nenit 63 të Ligjit nr.29/2023 “Të tatimit mbi të ardhurat”, mbi bazën e re të rivlerësuar dhe do të jenë në total 12 këste paraprake.
4. Nëse në deklaratën vjetore të TAK rezulton se tatimpaguesi për vitin 2027	• Duke qenë se tatimpaguesi realizon një rritje të fitimit të tatueshëm me 28,6% [$(3,600,000 \text{ lekë} - 2,800,000 \text{ lekë}) / 2,800,000 \text{ lekë}$], pra fitimi i tatueshëm për vitin 2027



ka një fitim të tatueshëm prej 3,600,000 lekë, sa është tatimi i llogaritur i tatimpaguesit për vitin 2027?	është mbi 18% dhe deri në 50%, dhe kushtet e tjera për përfundimin e marrëveshjes nuk janë cënuar, atëherë vijohet me llogaritjen e tatimit mbi fitimin. - Në rastin konkret norma tatimore do të jetë: - Për fitimin e tatueshëm deri në 3,304,000 lekë, subjekti do të paguajë normën standarde tatimore prej 15% të përcaktuar në Marrëveshje, dhe - Për çdo fitim shtesë mbi shumën 3,304,000 lekë, subjekti do të paguajë normën 5%. - Tatimi mbi të ardhurat e Korporates (TAK), i llogaritur për tatimpaguesin për vitin tatimor 2027 është: $= 15\% \cdot 3,304,000 \text{ lekë} + 5\% \cdot (3,600,000 \text{ lekë} - 3,304,000 \text{ lekë})$ $= 510,400 \text{ lekë tatim.}$ Kjo shumë duhet të rezultojë e paguar brenda datës 31.03.2028.
Shembulli nr. 2: Subjekti “A.B.”, person fizik i vetëpunësuar, në deklaratën e të ardhurave personale nga biznesi TAPB-së, për vitin 2026, ka deklaruar të ardhura bruto nga biznesi prej 21,524,000 lekë, ndërkohë fitimi i tatueshëm i realizuar për këtë periudhë ka qenë 2,460,000 lekë. - Për vitin 2027 subjekti, i cili plotëson të gjitha kriteret sipas ligjit “Për Marrëveshjen e Paqes Fiskale”, pasi ka dorëzuar deklaratën TAPB, aplikon brenda datës 31 Mars 2027 për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale. - Administrata tatimore, pas administrimit të kërkesës së tatimpaguesit, dhe verifikimit të kriterëve ligjore, mbi bazën e formulës së vlerësimit, harton dhe i propozon tatimpaguesit vlerën e paracaktuar të fitimit të tatueshëm, që do përdoret për llogaritjen e detyrimit tatimor gjatë periudhës së marrëveshjes, normën tatimore, si dhe për llogaritjen e kësteve paraprake dhe shpërndarjen e kësteve për periudhën e mbetur të vitit tatimor.	
1. Sa do të jetë fitimi i tatueshëm i vlerësuar për të cilin do të nënshkruhet marrëveshja?	- Fitimi i tatueshëm i vlerësuar në marrëveshje = Fitimi i vitit paraardhës për të cilin lidhet marrëveshja + $18\% \cdot$ e Fitimit të vitit paraardhës. $2,460,000 \text{ lekë} + 18\% \cdot 2,460,000 \text{ lekë} = 2,902,800 \text{ lekë}$ Pra marrëveshja me tatimpaguesin “A.B.”, për vitin tatimor 2027, do të nënshkruhet për fitimin e tatueshëm prej 2,902,800 lekë.



2. Cila do të jetë norma që do të aplikohet për fitimin e tatueshëm të vlerësuar në marrëveshje?	• Bazuar në pikën 2, të nenin nr. 24, të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, norma tatimore që aplikohet mbi fitimin e tatueshëm për personin fizik të vetëpunësuar objekt i këtij ligji, është progresive, konkretisht: - 15% për fitimin e tatueshëm deri në 14 milionë lekë, dhe - 23% për pjesën e fitimit të tatueshëm mbi 14 milionë lekë. • Personi fizik i vetëpunësuar, ka një fitim të tatueshëm të vlerësuar prej 2,902,800 lekë, pra më pak se 14 milionë lekë. Në këtë rast, për fitimin e tatueshëm të vlerësuar në marrëveshje, do të aplikohet vetëm norma standarde 15%. • Përsa më lart, në marrëveshje përcaktohet se norma tatimore për fitimin e tatueshëm të vlerësuar prej 2,902,800 lekë është 15%, dhe se për çdo fitim shtesë mbi vlerën 2,902,800 lekë do të paguhet tatim në masën 5% me dorëzimin e deklaratës tatimore të vitit 2027, brenda datës 31 mars 2028.
3. Sa do të jenë kështet e tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi që do të paguajë tatimpaguesi dhe si do të bëhet shpërndarja e kështeve për periudhën e mbetur të vitit tatimor?	1. Totali i vlerës së kështeve paraprake për t’u paguar do të jetë: $2,902,800 \text{ lekë} * 15\% = 435,420 \text{ lekë}$. 2. Shpërndarja e kështeve do të kryhen në Planin e Parapagimit, për periudhën Prill 2027 – Mars 2028, sipas nenit 63 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, mbi bazën e re të rivlerësuar dhe do të jenë në total 12 kështe paraprake.
4. Nëse në deklaratën vjetore të TAPB rezulton se tatimpaguesi për vitin 2026 ka një fitim të tatueshëm prej 3,250,000 lekë, sa është tatimi i llogaritur i tatimpaguesit për vitin 2027?	• Duke qenë se tatimpaguesi realizon një rritje të fitimit të tatueshëm me 32,1% $[(3,250,000 \text{ lekë} - 2,460,000 \text{ lekë})/2,460,000 \text{ lekë}]$, pra fitimi i tatueshëm për vitin 2027 është mbi 18% dhe deri në 50%, dhe kushtet e tjera për përfundimin e marrëveshjes nuk janë cënuar, atëherë vijohet me llogaritjen e tatimit mbi fitimin. • Norma tatimore sipas nivelit të të ardhurave do të jetë: a) Për fitimin e tatueshëm deri në 2,902,800 lekë subjekti do të paguajë normën tatimore prej 15% të përcaktuar në Marrëveshje, dhe b) Për çdo fitim shtesë mbi shumën 2,902,800,000 lekë subjekti do të paguajë normën 5%. • Tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi i llogaritur për tatimpaguesin për vitin tatimor 2027 është: $= 15\% * 2,902,800 \text{ lekë} + 5\% * (3,250,000 \text{ lekë} - 2,902,800 \text{ lekë})$ $= 452,780 \text{ lekë tatim}$ Kjo shumë duhet të rezultojë e paguar brenda datës 31.03.2028.



2. SHEMBUJ PËR RIDEKLARIMIN E ELEMENTETE VEÇANTË TË PASQYRAVE FINANCIARE VJETORE

Bazuar në pikën 2 të Nenit 6 të Ligjit Nr. 84/2025” Për Marrëveshjen e Paqes Fiskale” çdo element i rideklaruar në pasqyrat financiare mund të jete i ndryshuar deri në masën 30% dhe duhet të japë efekt neto në rritje në të ardhura apo kapital.

Shembulli 1:

Viti	2024					
	Zëri që rideklarohet	Gjendja e Llogarisë sipas pasqyrës së dorëzuar	Gjendja e Llogarisë sipas Rideklarimit	AKTIV Shtesa / Pakësimi	PASIV Shtesa / Pakësimi	Tatimi për t'u paguar
A	Aktive monetare	100.000	130.000	30.000		1,500
A	Aktive të tjera financiare afatshkurtra/					-
A	Fshirja e aktiveve afatgjata materiale/jo materiale					-
A	Deklarim i aktiveve afatgjata materiale/jo materiale					-
P	Fshirja e Detyrimeve/Borxheve					-
P	Rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij				30.000	1,500
	Shuma			30.000	30.000	3,000

Subjekti “A” rivlerëson vetëm zërin Aktive monetare, të cilin e ndryshon me rritje prej 30.000 lekë, nga 100.000 leke në 130.000 lekë dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/shtesë paguan tatim 5% të vlerës ose 1.500 lekë.

Efekti neto në rritjen e të ardhurave apo kapitalit është 30.000 lekë dhe duhet të paguajë 5% të vlerës ose 1.500 lekë.

Në total Subjekti “A” duhet të paguajë 3.000 lekë (1.500 lekë për ndryshimin e zërit Aktive monetare +1.500 lekë për ndryshimin e zërit Rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë).



Totali i tatimit të llogaritur pas rivlerësimit duhet paguar nëpërmjet ndryshimit të Deklaratës vjetore të Tatimit mbi Fitimin të vitit që i përket ndryshimi, pra e vitit 2024, duke plotësuar rubrikën (21) Tatim fitimi me përqindje të tjera.

Shembulli 2- I përgjithshëm.

Viti 2023

	Zëri që rideklarohet	Gjendja e Llogarisë sipas pasqyrës së dorëzuar	Gjendja e Llogarisë sipas Rideklarimit	AKTIV Shtesa / Pakësimi	PASIV Shtesa / Pakësimi	Tatimi për t'u paguar
A	Aktive monetare	100.000	130.000	30.000		1,500
A	Aktive të tjera financiare afatshkurtra/	200.000	140.000	-60.000		3.000
A	Fshirja e aktiveve afatgjata materiale/jo materiale	200.000	140.000	-60.000		3.000
A	Deklarim i aktiveve afatgjata materiale/jo materiale të papërfshira në PF	100.000	130.000	30.000		1.500
P	Fshirja e Detyrimeve/Borxheve	500.000	350.000		-150.000	7.500
P	Rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij				90.000	4.500
	Shuma			-60.000	-60.000	21.000



Subjekti B:

- Rivlerëson zërin Aktive monetare të cilin e ndryshon me rritje prej 30.000 lekë, nga 100.000 lekë në 130.000 lekë dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/shtesë paguan tatim 5% të vlerës ose 1.500 lekë.
- Rivlerëson zërin Aktive të tjera financiare afatshkurtra të cilin e ndryshon me ulje prej 60.000 leke, nga 200.000 leke në 140.000 leke dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/pakësim paguan tatim 5% të vlerës ose 3.000 lekë.
- Rivlerëson zërin Aktive afatgjata materiale/jo materiale me ulje prej 60.000 leke, nga 200.000 në 140.000 leke dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/pakësim paguan tatim 5% të vlerës ose 3.000 lekë.
- Rivlerëson zërin Aktive afatgjata materiale/jo materiale të papërfshira në pasqyrat financiare me rritje prej 30.000 lekë, nga 200.000 lekë në 140.000 lekë dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/shtesë paguan tatim 5% të vlerës ose 3.000 lekë.
- Fshin detyrime të parregullta/borxhe në masën 150.000 lekë, nga 500.000 lekë në 350.000 leke dhe ky ndryshim plotëson kushtin deri në 30% nga deklarimi fillestar. Për këtë ndryshim/pakësim paguan tatim 5% të vlerës ose 7.500 lekë.

Efekti neto në rritjen e të ardhurave apo kapitalit është 90.000 lekë dhe paguan 5% të vlerës ose 4.500 lekë.

Në total Subjekti B duhet të paguajë tatim 21.000 lekë (1.500 lekë për ndryshimin e zërit Aktive monetare +3.000 lekë për ndryshimin e zërit Aktive të tjera financiare afatshkurtra +3.000 lekë për ndryshimin e zërit Aktive afatgjata materiale/ jo materiale +1.500 lekë për ndryshimin e zërit Aktive afatgjata materiale/ jo materiale të papërfshira në pasqyrat financiare +7.500 lekë për fshirjen detyrime të parregullta/borxhe +4.500 leke efektin neto në rritjen e të ardhurave apo kapitalit).

Vlera prej 90.000 lekë e zërit rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij, bazuar në pikën 4 të nenit 6 të ligjit, mund të përdoret lirisht prej tyre për qëllime të biznesit apo personale, pasi të jetë sistemuar edhe pagesa e tatimit.

Totali i tatimit të llogaritur pas rivlerësimit duhet paguar nëpërmjet ndryshimit të Deklaratës vjetore të Tatimit mbi Fitimin të vitit që përket ndryshimi, pra në këtë rast në deklaratën për vitin tatimor 2023, duke plotësuar rubrikën (21) Tatim fitimi me përqindje të tjera.



UDHËZIM

Nr. 11, datë 14.5.2026

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 86/2025,
“PËR FSHIRJEN, SHUARJEN DHE
PAGESËN E DETYRIMEVE TATIMORE
NDAJ ADMINISTRATËS TATIMORE
QENDRORE E VENDORE DHE E
DETYRIMEVE TË PAGUESHME
NË DOGANË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 14 të ligjit nr. 86/2025, “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë”, ministri i Financave

UDHËZON:

I. OBJEKTI

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregulla dhe udhëzime për zbatimin e ligjit nr. 86/2025, “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë”, më poshtë referuar si “ligji”.

II. TATIMPAGUESIT/SUBJEKTET PËRFITUESE

1. Në zbatim të nenit 3 të ligjit, subjektet që do të përfitojnë të drejtën për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, janë si më poshtë:

a) Tatimpaguesit e regjistruar në regjistrin aktiv, pasiv, të çregjistruar ose me statuse të tjera në sistemin tatimor *e-Tax*, për detyrime tatimore ndaj administratës tatimore qendrore, sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11 të ligjit;

b) subjektet e regjistruara në regjistrin aktiv, pasiv, të çregjistruar ose me statuse të tjera në sistemin tatimor *e-Tax*, për detyrime tatimore ndaj administratës tatimore vendore, sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11 të ligjit;

c) Subjektet debitore ndaj administratës doganore për detyrime, sipas neneve 9, 10 dhe 11 të ligjit.

2. Organi tatimor qendror apo vendor dhe organi doganor, brenda datës 31.1.2027, publikojnë në faqen zyrtare web të institucionit, listën e plotë të 3 000 (tre mijë) tatimpaguesve/subjekteve që kanë

rezultuar me fshirjen/shuarjen më të madhe të detyrimeve, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në çdo rast, në listë të përfshihen të gjithë tatimpaguesit/subjektet, të cilave u është fshirë/shuar detyrimi jo më i vogël se 5 milionë lekë.

III. TATIMPAGUESIT/SUBJEKTET QË NUK PËRFITOJNË

1. Në zbatim të nenit 4 të ligjit, nga fshirja/shuarja e detyrimeve nuk përfitojnë tatimpaguesit/subjektet, që kanë detyrime tatimore/detyrime të pagueshme në doganë, të cilët janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose janë në proces gjyqësor apo hetimi për vepra penale në fushën tatimore dhe/ose doganore, në kuptim të legjislacionit të fushës, përpara ose gjatë kohëzgjatjes së zbatimit të këtij ligji.

2. Organi tatimor qendror, organi tatimor vendor dhe organi doganor, bazuar dhe në informacionin e siguruar nga organet e pushtetit gjyqësor, Ministria e Drejtësisë dhe/ose institucionet në varësi të saj, apo organet e pavarura të drejtësisë, sipas pikës 2 të nenit 4 të ligjit, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij udhëzimi, duhet të përgatisin listën e tatimpaguesve/subjekteve që nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve. Kjo listë përditësohet çdo muaj.

3. Listat e detajuara dhe të përditësuara do të shërbejnë për njoftim zyrtar të tatimpaguesve/subjekteve që përjashtohen nga zbatimi i ligjit. Njoftimi zyrtar i tatimpaguesve/subjekteve për organin tatimor qendror bëhet në llogarinë e tyre në *e-Filing*, ndërsa për organin tatimor vendor dhe doganor bëhet me shkresë zyrtare.

4. Për tatimpaguesit/subjektet për të cilët gjatë zbatimit të këtij ligji fillon një proces gjyqësor apo hetimor për vepra penale në fushën tatimore dhe/ose doganore, procedura e faljes, nëse është zbatuar, anulohet. Organi tatimor qendror, apo vendor, dhe organi doganor, marrin masat për rivendosjen e detyrimeve që kanë ekzistuar përpara përfitimit. E njëjta procedurë ndiqet edhe në rastet kur konstatohet që tatimpaguesi/subjekti ka përfituar gabimisht nga dispozitat e këtij ligji. Në të gjitha rastet, kur bëhet anulimi i fshirjes/shuarjes së detyrimeve, njoftohet zyrtarisht edhe tatimpaguesi/subjekti.

IV. FSHIRJA E DETYRIMEVE TATIMORE

1. Fshihen automatikisht detyrimet tatimore të papaguara sipas përcaktimit në pikën 1 të nenit 2 të ligjit, që u përkasin periudhave tatimore dhjetor



2014 e më parë, dhe që rezultojnë të llogaritura apo të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit, përveç kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Këtu përfshihet çdo detyrim tatimor i regjistruar në sistemin informatik ose jashtë sistemit, por që është i regjistruar në kontabilitetin e drejtorive rajonale tatimore.

2. Fshihen/shuhet detyrimet e papaguara, të përcaktuara sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, që u përkasin periudhave tatimore deri në datën 31 dhjetor 2014.

3. Fshihen automatikisht gjobot dhe kamatëvonesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore para 31 dhjetor 2014, që rezultojnë të regjistruara në llogarinë e subjektit, përfshirë të vetëpunësuarit në bujqësi, por pa përfshirë kontributin.

4. Pavarësisht nga përcaktimet në pikat 1 dhe 2 të këtij kreu, në rastin kur është paguar principi dhe tatimpaguesi ka detyrime të papaguara vetëm gjoba dhe kamatëvonesa në llogarinë e tij, falen gjobot dhe kamatëvonesat.

5. Fshihen detyrimet tatimore të papaguara, të vendosura për subjektet e çregjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) pas datës së çregjistrimit, të cilat janë evidentuar dhe kontabilizuar në regjistrat e administratës tatimore deri në datën 31.12.2024, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

6. Për rastet kur data e njoftimit, apo aktkonstatimi mban datën 31.12.2014 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse, sipas parashikimeve të këtij kreu.

7. Organi tatimor qendror/vendor administron listat e detajuara të tatimpaguesve që kanë përfituar nga fshirja automatike, apo manuale sipas këtij kreu.

V. FSHIRJA/SHUARJA E DETYRIMEVE TATIMORE ME KUSHT PAGIMIN E TATIMIT/TAKSËS/TARIFËS/KONTRIBUTIT

1. Në zbatim të nenit 6 të ligjit, organi tatimor qendror/vendor brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, harton listën e plotë të të gjithë debitorëve, të cilët kanë detyrimet tatimore të papaguara dhe të evidentuara nga 1 janari 2015 deri më 31 dhjetor 2019.

Kjo listë do të konsiderohet si lista bazë në të cilën do të pasqyrohen debitorët, detyrimet e

pagueshme (principali) dhe gjobot/kamatëvonesat përkatëse.

2. Për detyrimet tatimore qendrore apo vendore, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, që u përkasin periudhave tatimore nga 1 janar 2015 deri më 31 dhjetor 2019, shuarja bëhet sipas njëres nga alternativat e mëposhtme që zgjedh tatimpaguesi:

a) Shuhet 50% e detyrimit tatimor (tatim/taksë/tarifë), si dhe fshihen plotësisht gjobot dhe kamatëvonesat përkatëse, me kushtin që pjesa e mbetur prej 50% të detyrimit tatimor të paguhet e gjitha njëherësh brenda datës 30.6.2026.

b) Shuhet 25% e detyrimit tatimor (tatim/taksë/tarifë), si dhe fshihen plotësisht gjobot dhe kamatëvonesat përkatëse, me kushtin që pjesa e mbetur prej 75% të detyrimit tatimor të paguhet brenda datës 31.12.2026.

3. Shuhet gjobot dhe kamatëvonesat për detyrimet tatimore që u përkasin periudhave tatimore nga data 1 janar 2020 deri në datën 31 dhjetor 2024, me kusht që tatimi/taksa/tarifa për periudhën përkatëse të paguhet e plotë (100% e principalit) brenda datës 31.12.2026.

4. Shuhet dënimet administrative (gjobot dhe kamatëvonesat) për sigurimet shoqërore e shëndetësore që u përkasin periudhave tatimore nga data 1 janar 2015 deri në datën 31 dhjetor 2024, që rezultojnë të llogaritura apo të regjistruara në llogarinë e tatimpaguesit, përfshirë të vetëpunësuarit në bujqësi, me kushtin që të paguhet 100% kontributi brenda datës 31.12.2026.

5. Nëse subjekti për periudhat e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij kreu nuk ka tatim/taksë/tarifë/kontribut (principal) për të paguar, duke qenë se e ka paguar më parë ose tatimi ka qenë zero, atëherë atij i aplikohet automatikisht fshirja/shuarja e kamatëvonesave dhe gjobave të mbetura pa paguar në llogari.

6. Për rastet kur data e njoftimvlerësimit apo aktkonstatimi mban datën 31.12.2024 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse sipas kushteve të këtij kreu.

VI. FSHIRJA/SHUARJA E DETYRIMEVE TATIMORE TË TJERA

1. Në zbatim të nenit 7 të ligjit, janë objekt i fshirjes/shuarjes detyrimet tatimore të mëposhtme, pavarësisht periudhës tatimore që i përkasin, me



përfshirjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore:

1.1 Fshihen/shuhen automatikisht detyrimet tatimore, përfshirë tatimin/taksën/tarifën, kamatë-vonesën dhe dënimet administrative për subjektet persona fizikë ose juridikë, të cilët rezultojnë të çregjistruar në QKB ose me vendim gjykate, apo që janë të çregjistruar në administratën tatimore deri në datën 31.12.2024.

1.2 Organi tatimor qendror/vendor përgatit listën e subjekteve sipas përcaktimeve të mësipërme, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të udhëzimit.

1.3 Tatimpaguesit përfitues të ligjit, sipas listës së përgatitur, pas kryerjes së fshirjes së detyrimeve nga sistemi, në mënyrë automatike do të çregjistrohen nga sistemi me datën efektive të çregjistrimit sipas listës, pa qenë i nevojshëm dorëzimi i deklaratave, me përjashtim të deklaratave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe të listëpagesave.

1.4 Për detyrimet vendore, organet e pushtetit vendor marrin masat për fshirjen e detyrimeve nga regjistrat përkatës.

2. Në zbatim të nenit 7, shkronja “b” të ligjit, fshihen/shuhen në mënyrë automatike dënimet administrative (gjobat) tatimore të llogaritura automatikisht nga sistemi për mosdeklarim në afat, sipas nenit 113 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të llogaritura deri më 31.12.2024, përfshirë edhe dënimet që lidhen me afatin e deklarimit të të punësuarve.

3. Fshihen/shuhen dënimet administrative (gjobat) për mosdeklarim në afat për deklarata të padorëzuara, që u përkasin periudhave deri në datën 31.12.2024, me kusht që çdo deklaratë e padorëzuar të dorëzohet deri në datën 30.6.2026.

4. Pavarësisht nga përcaktimet në pikën 3 të këtij kreu, dënimet administrative (gjobat) për mosdeklarim në afat për deklarata të padorëzuara si pasojë e gjenerimit të tyre nga ana e subjekteve individë për efekt deklarimi të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave që u përkasin periudhave deri në datën 31.12.2024 fshihen automatikisht, pa qenë i nevojshëm dorëzimi i deklaratave.

5. Fshihen/shuhen automatikisht dënimet administrative (gjobat) për dorëzim të vonuar të vendimit për destinimin e rezultatit dhe dorëzim me vonesë të pasqyrave financiare të aplikuara sipas ligjit

nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, të llogaritura deri në datën 31.12.2024.

6. Fshihen/shuhen gjobat dhe interesat e gjeneruara në sistem nga ndryshimi i listëpagesave për periudhat e kaluara, që rrjedhin nga zbatimi i një akti ligjor, apo nënligjor, me efekt prapaveprues, apo zbatimit të një vendimi gjykate të formës së prerë, sipas akt konstatimit me datë deri më 31.12.2024.

7. Për rastet kur sipas pikave të këtij kreu, data e akt konstatimit mban datën 31.12.2024 dhe më parë, ndërsa data e kontabilizimit është bërë pas kësaj date, fshirja/shuarja bëhet manualisht nga strukturat përkatëse.

VII. KOMPENSIMI I DETYRIMEVE DEBITORE ME TEPRICËN KREDITORE TË TVSH-SË DHE GJENDJEN KREDITORE TË TATIMEVE TË TJERA

1. Tatimpaguesit, që kanë teprice kreditore të TVSH-së ose të një tatimi tjetër, përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve tatimore, sipas neneve 5, 6, 7 dhe 11, të ligjit, pas kompensimit (zvogëlimit) të tepricës deri në masën e tatimit të papaguar.

2. Në rastet kur teprica nuk mbulon vlerën e plotë të tatimit të papaguar, atëherë duhet të kryhet pagesa për pjesën e mbetur pas kompensimit, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 6 të ligjit, dhe më pas bëhet fshirja/shuarja e kamatëvonesave dhe dënimeve administrative.

3. Përcaktimet e këtij kreu për kompensimin zbatohen automatikisht, pa kontroll, përveç rasteve të parashikuara në pikën 2, të nenit 11, të ligjit, për të cilat ky kompensim zbatohet kur tatimpaguesi heq dorë nga ankimi administrativ, ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës kompetente.

4. Në zbatim të ligjit dhe këtij udhëzimi, kompensimit do t’u nënshtrohen të gjitha detyrimet tatimore të papaguara, përfshirë tatimin mbi të ardhurat nga punësimi (TAP), me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

5. Transferimi automatik i kredisë do të përdoret vetëm për shlyerjen e principalit të detyrimit tatimor, pa u shpërndarë në kamatëvonesë, gjoba apo dënime administrative.

6. Kompensimi i tepricës kreditore të TVSH-së dhe çdo lloj tatimi duhet të përdoret për të përputhur fillimisht detyrimet brenda llojit të vetë të tatimit dhe, më pas, te tatimet e tjera, në përputhje



me parashikimet ligjore të nenit 73 të ligjit nr. 9920 datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Nga ky kompensim përjashtohen detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

VIII. FSHIRJA E DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË

Në zbatim të neneve 9, 10 dhe 11 të ligjit, degët doganore kryejnë evidentimin e plotë të të gjithë debitorëve ndaj administratës doganore bazuar në përcaktimet e ligjit, duke marrë në konsideratë datën e vendimit, llojin e detyrimit dhe periudhat përkatëse konkretisht; deri më 31.12.2014; 2015–2019; dhe 2020–2024.

Për këtë qëllim, degët doganore hartojnë edhe listat respektive të debitorëve sipas procedurave të mëposhtme të përcaktuara në këtë udhëzim.

Për të administruar gjithë procedurën e fshirjes sipas këtij ligji, kryetari i degës doganore ngre një komision në përbërjen e të cilit janë kryetari i degës doganore, juristi i degës doganore, specialisti i borxhit dhe specialisti i financës. Kryetari i degës mund të caktojë në përbërje të këtij komisioni edhe punonjës të tjerë të degës doganore.

IX. PROCEDURA QË DUHET NDJEKUR NË ZBATIM TË NENIT 9 TË LIGJIT

1. Në zbatim të nenit 9 të ligjit, dega doganore brenda 20 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, harton listën e plotë të të gjithë debitorëve, për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara dhe të evidentuara nëpërmjet vendimeve administrative deri më datën 31 dhjetor 2014.

2. Kjo listë do të përmbajë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat në lidhje me: emrin e kompanisë/individit, NIPT-in/ID, numrin dhe datën e vendimit administrativ, detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji, shumën e paguar nëse ka, shumën që fshihet/shuhet.

3. Kjo listë e plotë do të konsiderohet si lista finale mbi të cilën do të vazhdojë procedura e administrimit të fshirjes nga Komisioni. Komisioni, pasi verifikon saktësinë e listës, përmes një procesverballi të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Komisionit, miraton menjëherë fshirjen e këtyre detyrimeve. Lista e miratuar i kalon për fshirje zyrës së financës dhe zyrës së borxhit në degën doganore.

4. Lista e debitorëve përfitues, pasi u janë fshirë detyrimet e pagueshme në doganë sipas nenit 9 të ligjit, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

5. Debitorët të cilët kanë kryer pagesë të pjesshme të detyrimeve të pagueshme në doganë në zbatim të vendimeve administrative të specifikuara sipas nenit 9 të ligjit, përfitojnë nga fshirja vetëm për pjesën e mbetur të papaguar të detyrimeve të pagueshme.

6. Në zbatim të nenit 9 të ligjit, për subjektet që janë debitorë vetëm për gjoba dhe kamatëvonesa të lindura ndaj administratës doganore deri në datën 31 dhjetor 2014, Komisioni miraton menjëherë fshirjen e tyre, pavarësisht nëse detyrimi kryesor (taksë/tarifë) është paguar më parë.

X. PROCEDURA QË DUHET NDJEKUR NË ZBATIM TË NENIT 10 TË LIGJIT

1. Në zbatim të nenit 10, pika 1 të ligjit, dega doganore, brenda 20 ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, harton listën e plotë të të gjithë debitorëve për të cilët detyrimet e pagueshme në doganë, sipas kuptimit të pikës 2, të nenit 2 të ligjit, janë të papaguara dhe të evidentuara sipas vendimeve administrative nga 1 janari 2015 deri më 31 dhjetor 2019. Kjo listë do të konsiderohet si lista bazë në të cilën do të pasqyrohen debitorët, detyrimet e pagueshme (principali) dhe gjobat/kamatëvonesat përkatëse.

2. Për debitorët e përfshirë në listën sipas pikës 1 të këtij kreu, shuarja e detyrimeve kryhet nëse përmbushet një nga kushtet e mëposhtme: a) Paguhet 50% e detyrimit (taksë doganore, TVSH, akcizë, taksa kombëtare) njëherësh brenda datës 30.6.2026. Në këtë rast shuhet 50% e mbetur e detyrimit dhe 100% e gjobave dhe kamatëvonesave. b) Paguhet 75% e detyrimit (taksë doganore, TVSH, akcizë, taksa kombëtare) brenda datës 31.12.2026. Në këtë rast shuhet 25% e mbetur e detyrimit dhe 100% e gjobave dhe kamatëvonesave.

3. Dega doganore njofton debitorët për opsionet e pagesës. Debitori, brenda afateve të përcaktuara, paraqet pranë degës doganore mandatin e pagesës sipas opsionit të zgjedhur (50% ose 75%). Komisioni, pas verifikimit të pagesës së kryer sipas kushtit, miraton shuarjen e pjesës së mbetur të detyrimit (50% ose 25% respektivisht), si dhe fshirjen e të gjitha gjobave dhe kamatëvonesave përkatëse. Lista e debitorëve përfitues i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.



4. Në zbatim të nenit 10, pika 3 të ligjit, dega doganore evidenton debitorët për periudhën 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2024. Për këta debitorë shuhen gjobat dhe kamatëvonesat, me kusht që detyrimi (principal) për periudhën përkatëse të paguhet i plotë (100%) brenda datës 31.12.2026. Procedura e verifikimit dhe e shuarjes nga Komisioni është e njëjtë me atë të përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu.

5. Nëse principal është paguar përpara hyrjes në fuqi të ligjit dhe subjekti ka vetëm gjoba dhe kamatëvonesa të papaguara në llogari, ato fshihen automatikisht nga Komisioni.

6. Në zbatim të nenit 10, pika 4 të ligjit, Komisioni i degës doganore miraton fshirjen automatike të të gjitha detyrimeve të mbetura pa paguar deri në vlerën 1 500 (një mijë e pesëqind) lekë për subjektet që nuk kanë detyrime të tjera.

7. Në zbatim të nenit 10, pika 5 të ligjit, Komisioni miraton fshirjen automatike të detyrimeve për individët debitorë pa numër identifikimi (ID), ose që kanë zhdoganuar me NIPT-in e përgjithshëm A000000A, për të cilët nuk ka vendim për rikuperim me forcë. Lista e këtyre individëve hartohet nga dega doganore, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e udhëzimit.

XI. DETYRIMET TATIMORE DHE DETYRIMET E PAGUESHME NË DOGANË QË JANË NË PROCES ANKIMIMI

1. Në zbatim të nenit 11, pika 1 të ligjit, nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja e detyrimeve tatimpaguesit/subjektet që kanë detyrime tatimore/detyrime të pagueshme në doganë, për të cilët ka vendim gjyqësor të formës së prerë për këto detyrime me palë fituese administratën doganore/tatimore, në kuptim të legjislacionit të fushës. Kjo pikë zbatohet nga secili institucion për detyrimet që janë në fushën e tij të përgjegjësisë.

2. Tatimpaguesi/subjekti, me përjashtim të atyre të përcaktuar në pikën 1 të këtij kreu, i cili është në proces ankimi administrativ ose gjyqësor për detyrimet tatimore/detyrimet e pagueshme në doganë, i nënshtrohet këtij ligji, nëse ai heq dorë nga ankimi administrativ, ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit pranë gjykatës administrative kompetente. Kjo pikë zbatohet nga secili institucion për detyrimet që janë në fushën e tij të përgjegjësisë.

2.1 Të gjithë tatimpaguesit për gjobat e parashikuara në nenin 7 të ligjit (pikat “a”, “b”, “c”,

“ç”, “d”), përfitojnë nga zbatimi i ligjit, pavarësisht nëse janë në proces ankimimi, me kusht që për këto detyrime të mos ketë një vendim gjyqësor, sipas përcaktimeve kufizuese të pikës 1 të këtij kreu.

2.2 Për këtë qëllim, lista e subjekteve, të cilat janë në proces gjyqësor për vlerën dhe periudhën e detyrimit të ankimuar, do të përcaktohen nga ana e organit tatimor/doganor brenda 20 (njëzet) ditëve nga hyrja në fuqi e udhëzimit. Lista e subjekteve, të cilat janë në proces gjyqësor, do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të administratës tatimore/doganore.

2.3 Në momentin kur tatimpaguesi/subjekti paraqet pranë organit tatimor/doganor aktin e heqjes dorë nga ankimi administrativ ose nga e drejta e padisë/ankimit/rekursit, bëhet pjesë e shqyrtimit të ligjit.

2.4 Paraqitja e aktit nga ana e subjektit, sipas pikës 2.3 më sipër, nuk mund të jetë më vonë se data 30.11.2026.

3. Çdo drejtori rajonale tatimore, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të analizojë të gjitha marrëveshjet e pagesës me këste të detyrimit të papaguar, me qëllim përfshirjen e këtyre tatimpaguesve në procesin e shqyrtimit të ligjit, për pjesën e mbetur të detyrimit.

4. Administrata tatimore, apo doganore, për detyrimet që fshihen/shuhen sipas këtij ligji, në rastin kur i ka filluar, ndërpret procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve. Për detyrimet tatimore ose doganore që nuk përfitojnë nga falja sipas këtij ligji (përfshirë rastet e pikës 1 të këtij kreu), procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në legjislacionet përkatëse.

4.1 Për detyrimet tatimore, që nuk përfitojnë nga falja sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në kreun XI, “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4.2 Për detyrimet doganore, që nuk përfitojnë nga falja sipas këtij ligji, procedurat e mbledhjes së detyrimeve vijojnë të kryhen sipas përcaktimeve në Kodin Doganor dhe dispozitave zbatuese të tij.

XII. AFATI I ZBATIMIT DHE E DREJTA E ANKIMIT

1. E drejta e tatimpaguesve/subjekteve, që përfitojnë nga dispozitat e këtij ligji, ushtrohet



brenda afateve të përcaktuara në nenet përkatëse të ligjit, por jo më vonë se data 31.12.2026.

2. Tatimpaguesit/subjektet për të cilët shuarja e detyrimit aplikohet me kusht, nuk përfitojnë shuarje të detyrimit, nëse nuk përmbushin kushtet e pagesës brenda afateve të përcaktuara në ligj, 30.6.2026 ose 31.12.2026, sipas rastit.

3. Për çdo tatimpagues/subjekt që përfiton ose jo nga fshirja/shuarja e detyrimeve, organi përkatës nxjerr një akt administrativ për këtë qëllim brenda afatit të zbatimit të ligjit, duke njoftuar edhe tatimpaguesin.

3.1. Administrata tatimore pas përfundimit të fshirjes/shuarjes, sipas kushteve të përcaktuara në ligj, do të njoftojë tatimpaguesit në sistemin *e-Filing* me anë të një mesazhi i cili në përmbajtje të tij do të informojë, se: “Në zbatim të ligjit nr. 86, datë 12.12.2025, Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore ndaj administratës tatimore qendrore e vendore dhe e detyrimeve të pagueshme në doganë”, ju njoftojmë se efekti i tij është përfshirë në Situatën Tuaj Financiare në sistemin informatik”.

4. Tatimpaguesit/subjektet, të cilët sipas një vendimi të administratave përkatëse nuk përfitojnë nga fshirja/shuarja sipas këtij ligji, kanë të drejtë të ankohen në gjykatën administrative, sipas legjislacionit të fushës në fuqi.

XIII. ORGANET ZBATUESE DHE AFATI PËR FSHIRJEN E DETYRIMEVE TATIMORE DHE DETYRIMEVE TË PAGUESHME NË DOGANË

1. Brenda datës 31.12.2026, organet përkatëse fshijnë nga regjistrat e tyre kontabël dhe nga llogaria

e subjektit debitor, detyrimet që fshihen sipas këtij ligji. Për të gjitha pagesat e kryera nga tatimpaguesi brenda afatit të zbatimit të ligjit por të reflektuara apo evidentuara në sistemin elektronik pas këtij afati, sistemimet nga organet përkatës do të bëhen/mbyllen brenda datës 15.1.2027.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me urdhër të brendshëm përcakton detyrat e çdo funksioni dhe njësie të deleguara për zbatimin e këtij ligji.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ngre një grup pune i cili do të monitorojë zbatimin e ligjit dhe këtij udhëzimi nga strukturat përkatëse në nivel qendror dhe rajonal.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mund të përcaktojë rregulla më të detajuara për trajtimin e rasteve specifike.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore mund të përcaktojë rregulla më të detajuara për trajtimin e rasteve që janë në fushën e përgjegjësisë së këtij institucioni.

7. Njësitë e qeverisjes vendore mund të përcaktojnë rregulla më të detajuara për trajtimin e rasteve që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Petrit Malaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë

